URDHËR
Nr. 71, datë 17.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të ligjit nr. 9000, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, për nënshkrimin e të gjitha akteve që lidhen me procedurat e likuidimit për individët dhe subjektet e shpronësuara, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Hantin Bonati.
2. Z. Hantin Bonati të ndjekë dhe zbatojë kriteret dhe procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private, për interes publik", i ndryshuar, gjatë ushtrimit të fushës së përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri.
3. Urdhri nr. 12, datë 13.1.2026, i zëvendëskryeministrit dhe i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, "Për delegim kompetence", shfuqizohet.
4. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Hantin Bonati, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi